

NDËRTIMI I LLOGARIVE TË VENDIT DHE STATISTIKA

Gjergji Mano

INSTAT

1. Ç'ËSHTË KONTABILITETI KOMBËTAR

Kontabiliteti Kombëtar ka lindur si nevojë e analizës makroekonomike për të disponuar një instrument matjeje, për të verifikuar hipotezat e saj dhe për të propozuar masa, që do të kenë pasoja të rëndësishme në historinë ekonomike të vendit. Nga eksperiencia e shumë vendeve, një rol i tillë tashmë është plotësisht i konfirmuar. Kontabiliteti Kombëtar tashmë ka pushtuar hapësira të reja. Megjithatë nuk është e padobishme që të njihet kjo nevojë të cilën ky sistem është në gjendje ta plotësojë.

Disa vende akoma nuk janë ndërgjegjësuar për këtë nevojë për shkak të vështirësive të grumbulluara për të arritur në cilësinë e treguesve të Kontabilitetit Kombëtar. Por, kjo nuk do të thotë që instrumenti i KK të jetë pa interes; që kur një vend dëshiron të veprojë për të ardhmen e tij ekonomike, një matje e tillë është e nevojshme. Në këtë këndvështrim, kontabilistët kombëtarë kanë, pra, një rol për të luajtur me qëllim që "produkti i tyre" t'u përgjigjet më mirë funksioneve, që ai është në gjendje të përmbushë.

2. NEVOJAT QË PLOTËSON KONTABILITETI KOMBËTAR

Ndër nevojat që KK mund të plotësojë, le të citojmë më në veçanti, aspektet e mëposhtme:

1. KK është një mjet i shkëlqyer informacioni i vënë në dispozicion të vendit për të njohur ekonominë e tij, sa në strukturë aq edhe në evolucion; nëpërmjet tij, i paraqitet publikut një kuadër koherent, i plotë dhe i përherëshëm, që krijon lehtësi për të kapur treguesit kryesorë ekonomikë; vendimmarrësit disponojnë, nga ana e tyre, një instrument që u krijon atyre mundësinë për të bërë zgjedhjet e duhura, në kuadrin e ekonomisë kombëtare.
2. KK është një instrument i përdorur për parashikimin ekonomik, konform me objektivin, që ishte caktuar që në fillim.
3. KK përdoret si një kuadër orientues për pjesën më të madhe të statistikës. Ky rol, tashmë, ka marrë një rëndësi të veçantë.

Ballafaqimi i burimeve, vënia në përputhje e nomenklaturave, harmonizimi i procedurave të mbledhjes e trajtimit janë nxitjet, që i japin aparatit statistikor një përdorim të menjëhershëm, duke krijuar hapësira mendimi në procesin e prodhimit të statistikave.

4. Një formalizim të gjuhës ekonomike: debati politik dhe social hapet gjithnjë e më tepër drejt kërkesave ekonomike. KK kontribuon në ndërtimin e një gjuhe të përdorueshme për të gjithë bashkëbiseduesit e këtij debati. Sigurisht, që kjo është e kritikueshme, sepse nuk është një referencë absolute për t'ju imponuar të gjithëve.
5. Një instrument pedagogjik: KK ndërton një mjet të vlefshëm për mësimin e makroekonomisë.
6. Një mjet për krahasime ndërkombëtare: megjithëse kjo është shumë e rëndësishme, sigurisht nuk mund të pranohet që është motivi parësor për ndërtimin e tij. Megjithatë, duhet patur shumë vëmendje në përdorimin e krahasimeve të tilla.
7. Së fundi, KK plotëson edhe një nevojë tjetër po aq të rëndësishme si një instrument shumë i dobishëm për studiuesit dhe historianët në përpjekjet për të interpretuar kontekstin ekonomik të periudhave për të cilat ata interesohen.

Kontabiliteti Kombëtar ka për qëllim " të prodhojë" shifra dhe këtë gjë e realizon duke shërbyer si një instrument matjeje për gjithë ekonominë. Ndërkaq, një instrument i tillë nuk gjendet në një laborator, siç ndodh për fizikën apo për kiminë dhe ai nuk merr formën e një makine: është njeriu, që ndodhet në zemër të procesit, duke filluar nga marrja e informacionit deri në prodhimin e të dhënave finale, megjithëse, informatika sot merr një vend gjithnjë e më qendror për ta ndihmuar në këtë qëllim.

Një prodhim i tillë kërkon kohë, sepse detyra është mjaft e gjithanshme dhe e vështirë. Kjo punë i është besuar ekipit të llogarive kombëtare, pranë INSTAT, i cili ka filluar punën konkrete për të prodhuar, për një seri vitesh, të dhënat më të rëndësishme të vendit, në përputhje me përkufizimet ndërkombëtare të

hartuara për këtë qëllim (SNA'93/ESA'95). Por, natyrshëm, vlefshmëria e një instrumenti matjeje varet nga cilësia e ndërtimit të tij, aftësia për ta përshtatur atë gjatë rrjedhës së kohës, etj..

Puna në ekip dhe vazhdueshmëria e procedurave dhe e metodave përbëjnë prioritete absolute nga të cilat varet edhe vetë cilësia e instrumentit.

3. TEKNIKAT E PËRDORURA

Për të prodhuar rezultatet e pritura, është e nevojshme të zbatohen teknika, që fillojnë nga statistika në ekonomi duke kaluar nëpër të gjitha kompetencat e nevojshme për interpretimin e informacioneve të mbledhura. Dihet se sa të shumëllojshme janë aktivitetet në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre njësitë ekonomike të vendit tonë. Një punë e tillë mësohet vetëm pjesërisht në universitet; është kjo arsyeja, që përse shumë vite praktikë janë të nevojshme për një kontabël kombëtar para se të jetë në gjendje të ushtrojë plotësisht mjeshtrinë e tij. Pra, eksperiencia e përfutur i jep atij një vizion shumë më të plotë për realitetin ekonomik të vendit dhe e vendos në qendër të debateve ekonomike që zhvillohen.

Ajo çka pritet nga kontabilisti kombëtar, është që t'i paraqesë vendit imazhin e tij, të sintetizuar dhe të shifruar, duke marrë parasysh të gjitha informacionet e disponueshme. Për të arritur këtu, nuk është çështja thjesht në transformimin e drejtpërdrejtë të të dhënave statistikore të mbledhura: gjithçka duhet kaluar në një fazë shqyrtimi kritik, ballafaques. Sigurisht, në këtë proces, kaq të ndërlikuar, puna nuk kufizohet vetëm në hapësirat e njohura: edhe zonat e "errëta" kanë po aq rëndësi sa ato ku informacioni është i bollshëm.

4. TË VLERËSOSH, TË MATËSH EKONOMINË

Të llogaritesh, të evidentosh do të thotë t'i shoqërosh një numër një fenomen, nëpërmjet një instrumenti që e kap informacionin dhe e interpreton. Vlerësimi i një fenomeni mund të kufizohet me një numër, por ai i korrespondon një tërësie numrash të lidhur midis tyre. Në ekonomi, dallojmë dy nivele matjeje, sipas asaj që interesohemi për ngjarjet apo për fenomenet konceptualisht të përcaktuara:

- **Niveli i parë** i matjes korrespondon me mbledhjen statistikore të të dhënave. Statisticienët grumbullojnë informacionin elementar në bazë të vrojtimeve me zgjedhje, e të tjera metoda dhe në bazë të agregimit që përdorin, ata propozojnë një imazh të shifruar për fenomenin e vrojtuar.
- Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për matjen që lidhet me **nivelin e dytë**. Këtij niveli nuk i shoqërohet një numër i caktuar për një ngjarje të veçantë, por propozohet të maten drejtpërdrejt fenomenet, pavarësisht nga kompleksiteti që paraqesin, që karakterizojnë ekonominë: si papunësia, inflacioni, prodhimi.... Për të arritur këtu është e nevojshme të bashkohim burimet e ndryshme dhe t'u bësh atyre një sintezë. Kontabiliteti Kombëtar i përket këtij niveli, sepse pretendon të matë ekonominë kombëtare. Në rastin e Kontabilitetit Kombëtar, matja korrespondon me shumë tabela, që përfshijnë të dhëna të artikuluar midis tyre nëpërmjet një kuadri kontabël. Për të bërë këto vlerësime, pra, u duhet bërë apel të gjitha burimeve ekzistuese (në veçanti atyre që rrjedhin nga niveli i parë), duke pasur si objektiv për t'i vënë ato në koherencë sipas kuadrit të përcaktuar kontabël, që është plotësisht i përcaktuar në SNA'93/ESA'95.

5. REGJISTRIMI I BURIMEVE EKZISTUESE

Mbledhja e informacionit të nevojshëm për përpunimin e llogarive kombëtare siç e përmendëm, kryhet duke u mbështetur në të gjitha burimet statistikore të disponueshme. Ky parim duhet marrë në sensin e gjerë të fjalës: pra, nuk duhet të kufizohemi vetëm me statistikat e përpunuara prej shërbimeve përkatëse të specializuara, nga ana tjetër, nuk mund të kënaqemi me një burim të vetëm për një tregues të dhënë kur, në fakt, ekzistojnë shumë burime të tjera.

Një karakteristikë tjetër e kontabilitetit kombëtar është se përpunimi i të dhënave për këtë qëllim prek gjithmonë të kaluarën: në momentin e angazhimit të punimeve, në përgjithësi, është shumë vonë për të përfytyruar realizimin e mbledhjeve të reja statistikore. Në këtë rast, angazhohen shumë punime plotësuese mbi një mbledhje tashmë të realizuar. Përmirësimi, gjithmonë i dëshirueshëm, i punimeve statistikore i sjell frutet e tij në kontabilitetin kombëtar vetëm në një të ardhme pak a shumë të largët. Për këtë arsye, është **shumë i dëshirueshëm dhe i domosdoshëm programimi i përbashkët** për transformimin e tyre.

Të bësh inventarin e burimeve statistikore presupozon më shumë se një listim të tyre. Një numër i madh informacionesh janë të nevojshme, ndër të cilat mund të theksojmë:

- kushtet e mbledhjes (formulari i përdorur, perioda e mbledhjes, skedari i referencës, momenti i mbledhjes,...);
- nomenklaturat e përdorura për pyetësorët, dhe sidomos për agregimet e përdorura;
- procedurat e ndjekura për trajtimin e të dhënave, afatet e prodhimit dhe të vënies në dispozicion të të dhënave;
- etj..

Nuk duhet menduar se INSTAT duhet të jetë i vetmi prodhues dhe mbajtës i informacioneve të përdorura. Administratat e ndryshme janë vendet e privileguara ku trajtohen këto të dhëna, që lidhen me aktivitetet, të cilat janë të fushës së tyre. Njëkohësisht, këto informacione ndodhen edhe nëpër dokumente të ndryshme të bëra publike, në monografi të botuara nga studiues të ndryshëm, universitete, e të tjera qendra shkencore. Këto informacione mund të paraqesin aktivitete të ndryshme dhe që shumë mirë shërbejnë për pika niseje të një analize. Pra, kemi të bëjmë me një aspekt “ gjurmues” në një kërkim të tillë.

a) Inventari i statistikave “të mëdha”.

Në vendin tonë konstatohet një numër i madh pikash të përbashkëta ashtu si në vendet e tjera, përse i përket vendndodhjes të statistikave. Në vija të përgjithshme mund të paraqesim këtë pamje:

1. Kontabiliteti i njësive institucionale të marra me rrugë direkte:
 - **administrata publike:** marrja e të dhënave kontabile për njësitë e këtij sektori në parim nuk duhet të shtrojë probleme. Megjithatë, është pak më ndryshe në realitet;
 - organizma të kontrolluar nga administrata: ndërmarrje publike, industriale apo të një karakteri tjetër, që varen nga sektori publik.
2. Kontabiliteti i njësive institucionale (ndërmarrjet) të marra me rrugën e mbledhjes: në kushtet e mosngarkimit të një organizmi të caktuar për të siguruar kontrollin e tyre, praktika është e tillë që, megjithëse, INSTAT është caktuar në ligjin e Kontabilitetit, neni 18, për të pasur dy kopje të bilancit vjetor për çdo ndërmarrje, këto të fundit, e kanë më të lehtë (pse jo edhe të panjohur) t'i dorëzojnë ato vetëm në organet tatimore.
3. Regjistrime ekonomike: regjistrimet e njësive ekonomike bujqësore, e të tjera të kësaj natyre.
4. Anketa ekonomike; dallojmë kryesisht :
 - Anketa pranë ndërmarrjeve ekonomike: INSTAT, qysh prej vitit 1997, ka filluar anketën strukturore të ndërmarrjeve (ASN) e cila është e organizuar në funksion të aktivitetit ekonomik të ushtruar dhe bën të mundur marrjen e një informacioni kontabël (llogaria Humbje Fitime) nëpërmjet të cilit, bën të mundur vlerësimin e të dhënave të prodhimit, konsumit ndërmjetës, etj. në nivel ndërmarrjeje. Në këtë kuadër, praktika e disa ministrive për ndërmarrjet, që i konsiderojnë në varësinë e tyre vazhdon për mbledhjen e të dhënave periodike për prodhimin, etj..
 - Anketa pranë familjeve, rasti i anketës për buxhetin e familjeve, të kushteve të jetës. Këto interesohen si për aspektet ekonomike e sociale të familjes ashtu edhe për aktivitetet e prodhimit, të ushtruara në gjirin e tyre.
5. Burime administrative të ndryshme: doganat (tregtia e jashtme); tatimet dhe taksat e mbledhura, kuotizacionet e ndryshme, papunësia, lejet e ndërtimit, regjistrimet e automjeteve, etj..
6. Të dhënat demografike: regjistrimet e popullsisë e të banesave.
7. Statistika mbi çmimet me pakicë e me shumicë.
8. Statistika të ndryshme me origjinë joadministrative.
9. Instrumente matjeje të nivelit të dytë siç është për shembull bilanci i pagesave.

c) Pikat e errëta të statistikës.

Gjithçka nuk është e matshme nga statistika.

Në raport me tërësinë e treguesve ekonomikë të parashikuar nga sistemi i Kontabilitetit Kombëtar, një numër jo i vogël i tyre vlerësohen keq bile ndoshta edhe jo nga statistika.

Shkaqet e këtij mosregjistrimi statistikor janë të ndryshme, le të shprehemi për disa, nga më kryesoret:

- **statistika shpreh një kosto**; pamjaftueshmëria e mjeteve financiare, sigurisht të çon në pamjaftueshmërinë e të dhënave, mosmbulimin e shumë fushave të aktiviteteve, etj.;
- atje ku ekziston një anketim, ai kryhet në referencë, me një popullatë teorike për t'u anketuar, por shumë individë mund t'i **shmangen mbledhjes statistikore**, gjë që çon në një mbulim të pamjaftueshëm. Cilatdo qofshin mënyrat dhe kushtet e mbledhjes, përqindja e përgjigjes kurrë nuk është e përkryer; pra mbetet gjithmonë një punë e vështirë dhe e madhe për të rindërtuar informacionin në shkallën e popullsisë të njohur;
- nuk mjafton vetëm që individit të jetë i pyetur, për më tepër, informacioni i marrë **të jetë i saktë**; eksperiencia tregon që ndeshet shpesh fenomeni i kundërt në dhënien e përgjigjeve. Formularët në të shumtën e rasteve mbushen shumë keq nga ndërmarrjet; edhe në rastet e një pune shumë të madhe të bërë nga anketuesit, cilësia mbetet shumë e dyshimtë për të dhënat e agreguara; tashmë dihet dhe është mjaft klasike që ndërmarrjet preferojnë të plotësojnë rubrikën " Të tjera " në total, ndërkohë që nevojat janë për një njohje të detajuar të kësaj shume;
- së fundi, ekzistojnë **shumë fenomene, që mbeten të pakapshme**, kjo si për mungesë të metodave ose të mjeteve, ashtu edhe për arsye të vetë natyrës së objekteve që duhen matur (për shembull, evazioni fiskal, prodhimi i drogës, etj.).

Pavarësisht nga motivet e këtyre mosregjistrimeve, njohja dhe "inventarizimi i tyre" është një detyrë e rëndësishme për t'u bërë. Në raport me kontabilitetin kombëtar, mund të bëjmë komentet e mëposhtme:

- kufiri i mosregjistrimit varet më shumë nga statisticioni dhe metodat e tij të punës, se sa nga kriteret e lidhura me analizën ekonomike; për pasojë, ky kufi nuk mund të shërbejë në mënyrë absolute për të strukturuar analizën ekonomike;
- sido që të jetë, kufiri i mosregjistrimit në pjesën më të madhe 'varet' nga vullneti i statisticionit; pra, ai është variabël në kohë dhe si i tillë nuk mund të përshtaten nomenklaturat e përdorura nga statisticienët kur ai procedon në agregimin e të dhënave. Nomenklatura të tilla, më shumë më sens "vullnetar", nuk mund të përdoren në funksion të nevojave të analizës ekonomike;
- rrallë ndodh që një regjistrim statistikor të bëhet në mënyrë të përhershme. Shpeshtësia e tij duhet marrë parasysh. Për kontabilistin kombëtar, një **frequencë vjetore është domosdoshmëri**, sepse bën të mundur ndjekjen kohore, por theksojmë se të dhënat **ndërvjetore** (mujore, tremujore) janë njëkohësisht të domosdoshme për të arritur në një njohje më të mirë të fenomeneve ekonomike (pa harruar ndër të tjera që shtrohet problemi edhe për plotësimin e nevojave për ndërtimin e llogarive tremujore të kontabilitetit kombëtar). Sigurisht, regjistrimet dhe anketimet në periudha të caktuara sjellin një informacion të vlefshëm, por **mbeten të pamjaftueshme** për nevojat e kontabilistit kombëtar lidhur me zhvillimin në kohë dhe ndërtimin e serive kohore.
- Si konkluzion, mund të themi se mosregjistrimi statistikor është një fenomen, që i bindet disa rregullave mjaft specifike. Marrja parasysh në kontabilitetin kombëtar nevojit për pasojë trajtime krejtësisht të veçanta, që rrallë mund të mbështeten në hipotezat e përmbajtjes socio-ekonomike.

6. PËR TË KRYER NJË VLERËSIM TË MIRË TË PBB (GDP)

Për të arritur në një vlerësim të PBB, shumë rrugë janë të mundshme, të cilat ndryshojnë sipas situatave ekonomike dhe statistikave të ndërtuara.

Për të arritur në një zgjidhje sa më optimale për kushtet e vendit tonë, kemi marrë parasysh edhe gjendjen e përgatitjes së të dhënave, mbështetur edhe në rekomandimet ndërkombëtare.

FAZAT E REKOMANDUARA TË IMPLEMENTIMIT

Faza	Përshkrim i përgjithshëm	Përshkrim i detajuar
Faza paraprake	Të dhëna bazë	Të dhëna mbi prodhimin, tregtinë, çmimet, etj..
Faza e parë ¹	Tregues bazë të prodhimit të brendshëm	Shpenzimet përfundimtare të PBB, me çmime korente dhe konstante, PBB sipas degëve me çmime korente dhe konstante.
Faza e dytë	E ardhura kombëtare bruto dhe tregues të tjerë kryesorë	Llogaria e jashtme e të ardhurave të para dhe transfertave korente, llogaria e kapitalit dhe financiare për botën e jashtme.
Faza e tretë	Llogaritë e sektorëve institucionalë: hapat e parë	Llogaritë e prodhimit për të gjithë sektorët institucionalë; gjenerimi i të ardhurave, ndarja e parë e të ardhurave, shpërndarja e dytë e të ardhurave, përdorimi i të ardhurave, llogaritë kapitale dhe financiare për administratën publike.
Faza e katërt	Llogaritë e sektorëve institucionalë: hapat ndërmjetës	Gjenerimi i të ardhurës, caktimi i të ardhurës së parë, shpërndarja e dytë e të ardhurave, përdorimi i të ardhurave, llogaritë kapitale për të gjithë sektorët institucionalë, përveç administratës publike .
Faza e pestë	Llogaritë e sektorëve institucionalë: hapi i fundit i llogarive të transaksioneve	Llogaritë financiare për të gjithë sektorët institucionalë, përveç administratës publike.
Faza e gjashtë	Transaksione të tjera të llogarive dhe bilanceve	Ndryshimet e tjera në llogaritë kapitale për të gjithë sektorët institucionalë; bilancet.

Për realizimin e këtyre rekomandimeve është i domosdoshëm caktimi i burimeve për çdo fazë, të cilat do të bëjnë të mundur rritjen e cilësisë. Të dhënat bazë të treguara në fazën përgatitore përfshijnë statistika mbi prodhimin bujqësor dhe industrial, tregtinë e jashtme, çmimet, punësimin, tregtimin me pakicë, ndërtimet, shpenzimet e familjeve. Në fazën e dytë sistemi i të dhënave plotësuese, përfshin për një numër të kufizuar produktesh, të dhëna mbi burimet dhe përdorimet e tyre me çmime korente dhe konstante, të cilat rekomandohen me qëllim për të vërtetuar konsistencën midis të dhënave të shpenzimeve dhe të vlerës së shtuar. Të dhëna të tjera përfshijnë sistemin e bilancit të pagesave dhe të statistikave financiare dhe monetare, të cilat tashmë korrespondojnë me pjesët e SNA-së, 93, pra këto të dhëna janë hartuar që të kenë mundësi të transferohen në llogaritë e SNA-së.

Për të arritur në një zgjidhje sa më optimale për kushtet e vendit tonë, kemi marrë parasysh tre elemente kryesore:

- madhësinë relative të përbërësve të ndryshëm të ekonomisë kombëtare (janë përcaktuar sektorët, aktivitetet ekonomike, mënyrat social-ekonomike të prodhimit),
- natyrën dhe llojshmërinë e informacioneve që disponohen,
- madhësinë dhe natyrën e mosregjistrimeve statistikore.

Lidhur me mosregjistrimet statistikore, theksojmë, se asnjë vend nuk mund t'i shmangët këtij fenomeni, por situatat janë shumë të ndryshme. Pra, bëhet fjalë për një vlerësim të fenomeneve të tilla siç janë, evazioni fiskal dhe ekonomia e fshehur, të gjitha këto vlerësime të shprehura në vite të ndryshme për

¹ Publikimi i të dhënave të kësaj faze parashikohet në maj 2001.

sektorë e degë të ndryshme të ekonomisë. Kuptohet, në kushtet e vendit tonë, vështirësia e madhe që ndeshet për këtë operacion të domosdoshëm vlerësues.

Një tjetër vështirësi e madhe e hasur në vlerësimet tona të viteve 1996-1998, është ballafaqimi dhe bërja koherente e burimeve të ndryshme të informacionit për të pasur një përafrim të PBB sipas metodave të njohura të prodhimit e shpenzimeve. Procedurat e aplikuara deri tani, tregojnë qartë se ekzistojnë shmangie të mëdha në këto informacione.

7. PRIVILEGJIM I BURIMEVE KONTABILE

Si një instrument i ndërtuar për të matur ekonominë, kontabiliteti kombëtar është konceptuar si një arkitekturë kontabile. Treguesit kryesorë ekonomikë, që rrjedhin nga ai, janë përcaktuar në mënyra riguroze dhe në lidhje me të tjerët.

Marrëveshjet ndërkombëtare, të ndërtuara në bazë të kësaj arkitekture marrin formën e nomenklaturave, ku treguesit e ndryshëm (prodhimi, të ardhurat, konsumi, etj.) paraqiten të lidhur ngushtë me aktorët ekonomikë që i realizojnë. Për më tepër, në sajë të një kuadri kontabël të përdorur, këta tregues rigrupohen në nënlllogari përfaqësuese specifike të jetës ekonomike.

Është kjo arsyeja që në kushtet e vendit tonë, duke qenë se ekziston një Plan Unik Kontabël për ndërmarrjet me karakter tregtar, i detyrueshëm për të gjithë personat juridikë, është konsideruar që ky lloj informacioni të jetë një nga burimet kryesore, të privileguara, që bën të mundur një transformim të kënaqshëm drejt treguesve makro-ekonomikë siç është PBB, etj..

Në praktikën tonë kemi bërë të mundur, me të dhënat në dispozicion, të vlerësojmë një numër treguesish si prodhimi, konsumi ndërmjetës dhe vlera e shtuar në nivele të ndryshme agregimi sipas nomenklaturave ndërkombëtare të përmendura më lart, mbështetur në informacionin e mbledhur për rreth 7600 subjekte ekonomike vepruese në vendin tonë, duke shfrytëzuar kryesisht llogarinë " Humbje Fitime".

Mbledhja dhe kontrolli i të dhënave kontabile individuale është një procedurë, që lidhet me njësitë informuese, në rastin e ndërmarrjeve, që detyrohen sipas ligjit të kontabilitetit, të mbajnë bilanc dhe që përbëjnë sektorin më të madh institucional, që sipas Kontabilitetit Kombëtar emërtohet, sektori i ndërmarrjeve jofinanciare.

Në këtë punë mjaft delikate, duke patur parasysh që përgatitja për kontabilitet kombëtar parashikon një punë paraprake statistikore mbi të dhënat me prejardhje burimesh të ndryshme të disponueshme, kemi synuar që t'i përshtatim ato me të dhëna për efekt të analizës makro-ekonomike të sistemit.

Disa prej këtyre burimeve statistikore (veçanërisht llogaria "Humbje Fitime") përmbajnë informacione shumë të vlefshme, që mund dhe duhet të përdoren kryesisht për të bërë sinteza të pjeshme për sektorë të veçantë. Dhe kuptohet që ne si kontabilistë kombëtarë duhet t'i shfrytëzojmë këto të dhëna në kuadrin e gjithë ekonomisë, sipas sektorëve.

Por, mendojmë se materiali statistikor, që ato paraqesin, duke qenë se është shumë i pasur me tregues, variabla, raporte, etj.,

është shumë i dobishëm edhe për përdorues të tjerë të mëdhenj të këtij lloji, si Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave, Ministrinë, që në linjën e tyre kanë nevojë për informacion (jo vetëm për sektorin shtetëror siç është tendenca e sotme), e shumë institucione të tjera të interesuara.

Sigurisht, secili mund të organizojë vetë këtë trajtim të të dhënave kontabile (rasti i Ministrisë të Ekonomisë Publike e të Privatizimit, ku theksojmë se nuk ka mundësi përdorimi të këtyre të dhënave).

Por, do të ishte shumë e preferueshme (shumë vende e kanë këtë praktikë) që të parashikohet një qendër trajtimi e informacionit kontabël, e centralizuar, e përqendruar. Një qendër e tillë, e unifikuar do të paraqiste në vetvete shumë përparësi:

- do të mundësohej një kursim fondesh në shkallë të lartë;
- do të garantohej cilësia më e mirë e të dhënave të përdorura nga njëri ose përdorues të tjerë;

- do të arrihej në një trajtim shumë më efikas e më homogjen, gjë që lehtëson punën për një sintezë finale.

Duke u nisur nga të dhënat individuale të disponueshme në bazat e të dhënave, do të arrihen disa objektiva të tjerë, që lidhen me rigrupimet sektoriale, ku mund të theksojmë:

- paraqitje, në mënyrë sa më të plotë, e njësive që përbëjnë sektorin apo nënsektorin;
- rigrupim sipas nomenklaturave përkatëse zyrtare ose të veçanta;
- rigrupim sipas kriterëve makroekonomike të Sistemit të Kontabilitetit Kombëtar;
- sigurim i përputhjes kohore me vitet e mëparshme;
- respektim, në mënyrën sa më të plotë i ekuilibre kontabile.

Kuptohet se realizimi i të gjitha këtyre punimeve duhet të përshtatet plotësisht edhe me ambientin informatik të nevojshëm.

Dhe duke marrë parasysh sasinë e madhe të informacionit, që duhet përpunuar, është e domosdoshme t'i bëhet "thirrje" këtij shërbimi. (Shih slide "trajtimi i të dhënave kontabile".)

Përdorimi i të dhënave kontabile të ndërmarrjeve me aktivitet ekonomik në vendin tonë, për vlerësimin e të dhënave të prodhimit, konsumit, investimeve, etj., megjithë vlerën e tyre, paraqitet i pamjaftueshëm.

Është e domosdoshme që të dhënat e përfituara më lart në nivele sektori², të transformohen në të dhëna sipas degëve homogjene³ dhe për më tepër në nivele produkti kryesor elementar.

Për këtë, duhet të disponohen të dhëna statistikore suplementare, të bazuara në të dhënat kontabile, ku ndër më të rëndësishmet mendojmë të jenë **anketat specifike të degës**, të cilat, të marra nga ndërmarrjet, në intervale tremujore, për njësitë më të mëdha edhe të mesme, do të kompletojnë, në përgjithësi, ato informacione bazë (sasitë e prodhuara, shitjet, gjendjet, kërkesat, çmimet, e shumë elemente të tjera informuese) që janë aq shumë të vlefshme, për të gjykuar ecjen e ekonomisë në përgjithësi, por edhe të degëve në veçanti.

Së fundi, dëshiroj të theksoj se sistemi statistikor shqiptar (SISTASH) kërkon një transformim rrënjësor për t'iu përgjigjur fenomeneve të reja të ekonomisë.

Ligji i sotëm "Për statistikën", i dha një impuls aktivitetit të SISTASH, duke parashikuar pjesëmarrjen në këtë sistem të shumë institucioneve e organizmave të tjerë dhe duke theksuar rolin kryesor të INSTAT në udhëheqje të këtij sistemi.⁴

Vetë ky sistem, nga ana e tij, ka nevojë të rishikohet, për të përfunduar vëmendjen në shumë aspekte juridiko-organizative, nga një këndvështrim i pastër statistikor, nisur nga konsiderata që informacionet statistikore përbëjnë një instrument shumë të vlefshëm si për marrjen e vendimeve, formulimin e programeve qeveritare, të administrimit publik, të shtypit, etj., ashtu edhe si një mjet verifikimi për veprimtarinë e aspekteve të shumta të jetës sociale e ekonomike të vendit.

Hapi pozitiv i ndërmarrë për funksionimin, për herë të parë në SISTASH, të Këshillit Kombëtar të Statistikës (KKS), në zbatim të nenit 8, si një organ konsultativ i përbërë nga drejtues të administratave dhe të enteve, që përbëjnë në përgjithësi sistemin, është shumë shpresëdhënëse. KKS me veprimtarinë e tij, duke ushtruar funksione direktive për punimet statistikore të INSTAT, do të orientojë drejt debatet dhe diskutimet e shumta për të arritur ndërtimin e një Programi Statistikor Kombëtar (PSK), i cili në vetvete duhet të koordinojë e të programojë punimet statistikore, që duhet të ndërmerren nga ministritë apo institucionet e ndryshme, duke përfunduar formën e bashkëpunimit në plan metodologjik e organizativ, duke stabilizuar mënyrat e marrjes, të përpunimit e të shkëmbimit të informacionit, që institucionet publike, zyrat, entet dhe organizmat e ndryshëm të SISTASH synojnë të realizojnë për periudhat përkatëse.

Shënim: Për përgatitjen e këtij materiali janë shfrytëzuar edhe eksperiencia, botime, monografi, konkluzione e orientime të paraqitura në seminare të ndryshme të organizuara nga EUROSTAT, në fushën e kontabilitetit kombëtar.

² Sektori korrespondon me rigrupimet e ndërmarrjeve, që kanë të njëjtin aktivitet kryesor.

³ Dega korrespondon me rigrupimet e njësive lokale që kanë të njëjtin aktivitet kryesor.

⁴ Neni 2, ligji "Për Statistikën", nr. 7687, datë 16.3.1993: Shërbimi statistikor kryhet nga Instituti i Statistikës, drejtoritë e statistikës në rrethe, drejtoritë (sektorët) e statistikës të ministrive e institucioneve të tjera qendrore, zyrat e gjendjes civile si dhe personat juridikë a fizikë".